# ZGJEDHJET PËR KUVENDIN

# 23 QERSHOR 2013

# MANUALI I PUNËS SË GRUPIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

## Përmbajtja e lëndës

I. GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE...................... 3

1. Parimet e punës së GNV-ve ........................................................................... .3

2. Ngritja e GNV ........................................................................................ ......4

3.Pwrgatitja e VNV-ve.......................................................................................................5

4. Vendosja e VNV-së.........................................................................................................5

5. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor bazë për GNV-të..........................................................6

6. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave..................................................6

7. Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave.........................................7

II. MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE..................................................8

1.Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga grupet e marrjes në dorëzim....................8

2. Kutitë e parregullta.................................................................................................. 10

III. PROCESI I NUMËRIMIT ........................................................................................11

1. Veprimet paraprake të KZAZ ..................................................................................14

2. Fillimi i procesit të numërimit.................................................................................12

3. Hapja e Kutive të Votimit.......................................................................................12

4. Hapja e kutive të materialeve të votimit................................................................ 14

5. Vlerësimi i fletëve të vlefshme dhe të pavlefshme....................................................15

6. Vlerësimi i fletës së votimit.........................................................................................20

7. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore ......................................................21

8. Nxjerrja e rezultatit ..................................................................22

9.TRANSMETIMI ELEKTRONIK, NXJERRJA E TABELËS PËMBLEDHËSE TË REZULTATEVE.........22

9.i.Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së.....22

9.ii.Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve nga KZAZ-ja model 57-13...24

Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje.............................................................25

IV. VËZHGUESIT.........................................................................................................26

1.Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesi.............................................................................26

2. Vëzhguesit në VN........................................................................................................27

V. PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET............................................................................28

1. Veprat penale..............................................................................................................28

Modelet e dokumentacionit të punës në VNV...............................................................29

KODI I SJELLJES

Manuali i punës së Grupit të Numërimit të Votave (GNV) ka kryesisht për qëllim të ndihmojë anëtarët e GNV-së dhe vetë anëtarët e KZAZ-ve në zbatimin korrekt të procedurave që ndiqen në Vendin e Numërimit të Votave nga fillimi i procesit të numërimit deri në nxjerrjen e rezultatit te zgjedhjeve nga KZAZ-ja.

Në përvetësim të Manualit, ata duhet të jenë të aftë të njohin dhe të aplikojnë dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akte nënligjore të cilat rregullojnë procesin e numërimit të votave në VNV.

Puna e GN-ve do të sigurojë që të drejtat e votuesve për të shprehur vullnetin e tyre lirisht në ditën e zgjedhjeve do të materializohet në numërimin korrekt të cdo vote të hedhur në Kutinë e Votimit. Manuali mund të jetë gjithashtu i dobishëm për të gjithë personat e interesuar, të cilët marrin pjesë në procesin zgjedhor, përfshi partitë politike, koalicionet, kandidatët, vëzhguesit zgjedhorë dhe median, për të kuptuar më mirë rregullat dhe procesin e numërimit të votave në vendin e numërimit të votave.

Ky manual shpjegon të gjitha hapat kyç që duhen ndjekur në disa faza të caktuara të procesit të numërimit të votave, duke filluar nga rregullimi i vendit të numërimit të votave deri në nxjerrjen dhe transmetimin e rezultateve të çdo ZAZ-je.

Ndërkohë që përgatitja dhe publikimi i manualit u mbështet nga Këshilli i Europës, opinionet e shprehura në manual nuk janë qendrimet zyrtare të Këshillit të Europës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë falenderon Këshillin e Europës për mbështetjen.

Ne shpresojmë se ky Manual do të shërbejë për edukimin dhe zbatimin në praktikë të të gjitha rregullave dhe procedurave që ndiqen në VNV, duke kontribuar në menaxhimin ligjor dhe eficent për këtë proces mjaft të rëndësishëm.

***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***

Shkurtimet e përdorura në Manual:

| | |
|---|---|
| **KZ** | Kodi Zgjedhor i Shqipërisë; |
| **KP** | Kodi Penal i Shqipërisë; |
| **KQZ** | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; |
| **KZAZ** | Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor; |
| **KQV** | Komisioni i Qendrës së Votimit; |
| **VNV** | Vendi i Numërimit të Votave; |
| **GNV** | Grupi i Numërimit të Votave |
| **n.** | Neni; |
| **p.** | Pika; |
| **sh.** | Shkronja; |
| **MODEL** | Model vendimi, tabele, procesverbali. |

# I. GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE QENDRAT E NUMËRIMIT TË VOTAVE

## 1. Parimet e punës së GNV-ve *(N. 3 KZ)*

Kodi Zgjedhor ka vendosur parimet e mëposhtme bazë në punën e zyrtarëve zgjedhore:

- **LEGJITIMITETI**
- **TRANSPARENCA**
- **PAANËSIA**
- **PROFESIONALIZMI**










Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, gjatë kohës që kryejnë detyrën e tyre, duhet të zbatojnë Kodin e Sjelljes, të printuar në kapakun e Manualit. GNV numëron votat në rang ZAZ-je, nxjerr rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV dhe plotësojnë Tabelë e rezultateve për çdo QV, Model **57-13.**

**Kujdes!**KZAZ nxjerr Tabelën Përmbledhëse e Rezultatit të Zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor **jo më vonë se ora $22^{00}$ e ditës së nesërme të votimit,** p.1, n.122 dhe merr Vendimin për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, Model **40-13 V**.

## 2. Ngritja e GNV *(n. 95 KZ, U 12)*

GNV-të ngrihen **10** ditë para Ditës së Zgjedhjeve. GNV-të përbëhen nga 4 anëtarë, megjithatë, nëse nuk është e mundur të plotësohet numri i kërkuar, një GNV **funksion me jo më pak sesa dy anëtarë.** p3, n. 95

Çdo Grup Numërimi përbëhet nga **numëruesi i parë, sekretari** dhe **2 anëtarë.**

GNV janë 2 për çdo tavolinë numërimi. Çdo GNV përbëhet nga katër persona për çdo tryezë numërimi. GNV-të **numërtohen** me numër rendor rritës dhe përfundojnë gjithnjë me numër çift.
Nëse është e nevojshme, **grupet e dyta** të Numërimit të Votave nisin menjëherë punën pasi GNV-ja e parë përfundon punën e saj.

Grupet e dyta qendrojnë në gadishmëri për të zëvendësuar grupet e para me vendim të KZAZ-së dhe nëse grupet e para e ndërpresin punën për arsye të pajustifikueshme. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit nuk futen në punë.

Një grup numërimi numëron **jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë se 10 qendra votimi**.





# 3. Përgatitja e VNV-së *(N. 94 KZ)*

Pajisjet logjistike të nevojshme për procesin e numërimit të votave ofrohen nga KQZ në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore. Pajisjet për regjistrimin në video sigurohen nga KQZ. Struktura e nevojshme logjistike për vendet e numërimit duhet të përfshijë edhe ndriçim të pandërprerë. Tavolinat e punës për çdo grup numërimi duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave dhe që të lejojnë instalimin e monitorëve dhe kamerave regjistruese.

Një vend numërimi votash nuk mund të ketë më pak se **5 dhe më shumë se 10** tavolina numërimi. Tavolinat e punës së grupeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KZAZ-së duhet të jenë në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave.

**Tavolinat e punës vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZAZ-së dhe nga vëzhguesit, kandidatët ose përfaqësuesit e medias. Vëzhguesit duhet të kenë mundësi të shohin se si vendosen fletët e votimit të subjekteve të ndryshme zgjedhore.**

Vëzhguesit duhet të rrinë në rreshtin e parë përballë monitorëve (ekraneve). **Vëzhguesit nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit/zgjedhore.**

VNV-të vihen në dispozicion të KZAZ-ve **jo më vonë se 10 ditë** para ditës së zgjedhjeve. **Pesë ditë** para ditës së zgjedhjeve, KZAZ-ja fton subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve që të njihen me VNN.

VNV-ja duhet të jetë e rregulluar me pajisjet logjistike të nevojshme, si më poshtë:

- **Tavolina pune dhe 8 karrige** për KZAZ-në;
- Tavolinë pune me 2 karrige për ndihmësit teknik;
- **Dyshe tavolinash** (vendosen sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;
- **Kompjuter, printer, fotokopje dhe telefon/fax** për KZAZ-në;
- **Struktura ndarëse të hapësirës** së publikut me hapësirën për numërimin e votave;
- Tabelat treguese të dërguara nga KQZ;
- **Tabelat treguese** për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV;
- **Karrige** për vëzhguesit. *(p. 4, n. 5 e U. 12)*

# 4. Vendosja e VNV



**Policia organizon ruajtjen e ambientit të Vendit të Numërimit të Votave prej orës 18$^{00}$ të ditës së zgjedhjeve deri në momentin e nxjerrjes së tabelave të rezultatit nga KZAZ-ja.**

**Punonjësi i Policisë së Shtetit qendron jashtë ambienteve të Vendit të Numërimit të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ-ja.** (p. 6,7, n. 5 i U 7)

## 5. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor bazë për GNV-të

Çdo VNV duhet të ketë në dispozicion të saj:

**Materialet zgjedhore për GN-të**

Materialet që i dërgohen KZAZ-së për GNV-të përcaktohen sipas një inventari, të ndara, si vijon:

**Dokumentacioni i punës:**

- Kod Zgjedhor;
- Manual;
- Procesverbal i mbylljes së Kutisë së Materialeve zgjedhore (Votimit) Model **PV-GNV-10**;


PV-GNV-10

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL


PV-GNV-10-1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

- Procesverbal i Grupit të Numërimit të votave për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara Model **PV-GN-10-1**;
- Tabelë e rezultateve për QV-të Model **57-13**, të cilën e nxjerr GNV;


QARKU ___________

GN NR _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ NR ___

TABELË E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Numri i zgjedhësve që kanë votuar | | |
| 2 | Fletë votimi të papërdorura | | |
| 3 | Fletë votimi të dëmtuara | | |
| 4 | Fletë votimi të gjetura në kuti | | |
| 5 | Vota të pavlefshme | | |
| 6 | Vota të vlefshme | | |

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

| Nr | Subjektet Zgjedhore | Numri i votave të vlefshme | |
|---|---|---|---|
| | | Me shifër | Me fjalë |
| 1 | | | |
| 2 | | | |
| 3 | | | |
| 4 | | | |
| 5 | | | |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |
| 9 | | | |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |
| | Gjithsej vota të vlefshme | | |

Kundërshtimet e anëtarëve të GN (në se ka)

1.Unë ___________ (emër, atësi, mbiemër), anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ___________

2. Unë ___________ (emër, atësi, mbiemër), anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ___________

3. Unë ___________ (emër, atësi, mbiemër), anëtar i GN nr.___, kundërshtoj tabelën për arsye se: ___________

| Nr. | Numri i kodeve të vulave që mbyllet kutia e votimit |
|---|---|
| 1 | |
| 2 | |
| 3 | |
| 4 | |
| 5 | |

Data e plotësimit ___.06.2013

Grupi i Numërimit Nr.___

| Nr. | Emri, Atësia, Mbiemri | Funksioni | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | | Numërues i parë | |
| 2 | | Sekretar | |
| 3 | | Anëtar | |
| 4 | | Anëtar | |

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 23.06. 2013

Modeli i miratuar me vendim të KQZ nr.18, datë 24.01.2013

Model: 57-13

- Tabelë Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së, të cilën e nxjerr KZAZ, Model **40-13**;

- Vendim për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, Model **40-13 V**.



**Set i kancelarive:**

- Shenjë dalluese për GN;
- Pincë për këputjen e kodeve të sigurisë;
- Dosje me llastik;
- Kartë identiteti; grafist modelet e ID per anetaret e GNV




- Letër A4;
- Stilolaps;



Vula me kod sigurie rezervë



- Kode/vula metalike;
- Makinë llogaritëse;
- Qirinj;
- Zarfa sigurie për fletë votimi të kontestuara, Z.04;
- Zarfa sigurie për fletë votimi të pavlefshme, Z.05;
- Zarfa për fletë votimi për secilin subjekt Z.06;

## 6. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave *(N. 3, U. 18)*

Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave – **videokamera dhe monitorë -** instalohet në çdo VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me një kamera dhe monitor.

KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie. Në rast se sistemi i teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, ka difekt në një apo më shumë tavolina numërimi, nuk pengohet procesi i numërimit të votave. **KZAZ-ja njofton ndihmësit teknikë dhe KQZ-në për defektin e ndodhur.** GNV-të vazhdojnë procesin e numërimit të votave. Në këtë rast, **KZAZ**-ja lejon vëzhguesit e koalicioneve që nuk kanë anëtar në GNV, **të afrohen pranë tavolinës së numërimit të votave. Kjo procedurë** dhe **ora e saktë e ndërprerjes**

dhe **rifillimit** të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit, **shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së**.

Në rast se grupi i numërimit të votave funksionon me **2 anëtarë,** ky proces duhet të jetë i regjistruar nga kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluara në ambientet e VNV-së. Në rast se **regjistrimi me kamera nuk funksionon** për çfarëdo arsye dhe numërimi i kutisë nuk ka përfunduar, atëherë numëruesit përfundojnë numërimin e kësaj QV dhe procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse (kamerave), ose plotësimin e grupit të numërimit të votave. **Kjo procedurë** dhe **ora e saktë e ndërprerjes** dhe **rifillimit** të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit, apo e plotësimit të grupit të numërimit të votave **shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së**.






## 7. Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave

(n. 121 KZ)

Në Vendin e Numërimit të Votave janë të pranishëm vetëm:

- anëtarët dhe sekretari i **KZAZ-së,**
- anëtarët e **GNV-ve,**
- **kandidatët,**
- **vëzhguesit** e subjekteve zgjedhore,
- vëzhgues të tjerë të akredituar,
- përfaqësuesit e akredituar të **medias**, si dhe
- **personeli teknik i** autorizuar nga KQZ për mirëmbajtjen e sistemit të kamerave.

KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për **moslejimin e personave të paautorizuar në VNV.** KZAZ duhet të emërojë një person për të kontrolluar hyrjen në VNV. Ky person duhet të verifikojë vlefshmërinë e dokumenteve të akreditimit. Përfaqësuesit e medias duhet të kenë një dokument që konfirmon se ata përfaqësojnë një media të caktuar.

KQZ i dërgon KZAZ-së një listë me emrat e kandidatëve të ZZ përkatëse dhe personi që kontrollon hyrjen në VNV, **çekon në listë, emrin e kandidatit të paraqitur me dokumentin e identifikimit.**



Vendime të KZAZ-së
Zgjedhjet për Kuvendin 2009

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR ___
QARKU__________________

MODEL – XX V

VENDIM
Nr. _____, datë ___.__.2009

PËR NJOFTIMIN E POLICISË SË SHTETIT

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Qarku _____________, sot në orën _____, duke qenë se në ambjentin e VNV-së ndodhen persona të paautorizuar dhe/ose rrezikohet rendi, bazuar në nenin 121, pika 2, të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", si dhe Udhëzimin nr.___, datë __.03.2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhjet për Kuvendin 2009",

VENDOSI:

1. Të njoftojë sot në datën ___.__.2009 ora _____ forcat e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e personave të paautorizuar dhe/ose rivendosjen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KQZ-së.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor NR.________
Qarku___________

| | | Pro/kundër | Firma |
|---|---|---|---|
| 1. ______________________ | Kryetar | _______ | _______ |
| 2. ______________________ | Zv/kryetar | _______ | _______ |
| 3. ______________________ | Anëtar | _______ | _______ |
| 4. ______________________ | Anëtar | _______ | _______ |
| 5. ______________________ | Anëtar | _______ | _______ |
| 6. ______________________ | Anëtar | _______ | _______ |
| 7. ______________________ | Anëtar | _______ | _______ |

VULA

Model i miratuar me Udhëzimin e KQZ-së Nr. __, datë __.03.2009

Vendime të KZAZ-së
Zgjedhjet për Kuvendin 2009

MODEL – XX V

Shënime:

Model i miratuar me Udhëzimin e KQZ-së Nr. ___, datë __.09.2009

Në rast të pranisë së personave të tjerë, KZAZ-ja, me vendim, Model **XX V**, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Të gjithë personat e pranishëm në VNV duhet të mbajnë një dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre.

# II. MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE





## 1.Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga grupet e marrjes në dorëzim *(n. 115 i KZ)*

**Kutitë me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit duhet të merren në dorëzim sapo të mbërrijnë në VNV.**
**Gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, grupet e marrjes në dorëzim të KZAZ duhet të plotësojnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim PV-KZAZ-09.**



PV-KZAZ-09

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Për dorëzimin në KZAZ nga KQV-të të materialeve zgjedhore për zgjedhjet Kuvendin e Shqipërisë të datës : 23 Qershor 2013
Baza ligjore: neni 115 pika 2, 3, 4,7,8, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| KZAZ: | | | Qarku: | |
| KQV Nr: | | | Datë: | |

KUJDES!

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Kuti Votimi me nr. të vulave të sigurisë: (kutia e votimit duhet të jetë e vulosur me 5 vula (kode) | | | | |
| | 1.1 Kjo kuti votimi është: | | 1.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara: | | |
| | a. e rregullt ☐ | b. e parregullt ☐ | | | |
| | KUTIA E VOTIMIT ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË: | | | | |
| | 1) | 2) | 3) | 4) | 5) |
| 2. | Kuti e Materialeve Zgjedhore me nr. të vulave (kodeve) të sigurisë: (duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode) | | | | |
| | 2.1 kutia e materialeve zgjedhore është: | | 2.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara: | | |
| | a. e rregullt ☐ | b. e parregullt ☐ | | | |
| | KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË: | | | | |
| | 1) | 2) | 3) | 4) | |
| 3. | VULA REZERVË TË PAPËRDORURA: | | | | |
| | 1) | 2) | 3) | | |
| 4. | Koha e marrjes në dorëzim : | Datë | / /2013 | Ora : | : |

| Punonjësi i Policisë se Shtetit: | Dorëzuesi nga: KQV nr. ______ | Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marrjes në dorzim: |
|---|---|---|
| | Kryetar: | Anëtar: |
| | Sekretar: | Anëtar: |

VULA e KZAZ-së

Shënim: Materialet të cilat duhen kthyer në KZAZ dhe më pas në KQZ, janë të inventarizuara dhe moskthimi i tyre ... me përgjegjësi financiare, kundrejt vlerës të pa-dorëzuar në KQZ.

PV-KZAZ-09 – – I miratuar me Vendim Nr.8, datë 10.01.2013 të KQZ-së

KZAZ-ja cakton për marrjen në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutive me materialet e votimit **një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim**. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Nëse gjykohet e nevojshme (vëren se krijohet radhë për dorëzimin e materialeve zgjedhore në VNV), KZAZ-ja mund të caktojë 2 persona në ndihmë të grupit për marrjen në dorëzim të kutive, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së dhe për të orientuar KQV-të. Personeli ndihmës zgjidhet nga lista e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave, duke garantuar në çdo rast baraspeshën politike shumicë-opozitë.

## Vendosja e kutive të Votimit ne VNV *(n. 120 KZ, n. 8, U 18)*

- KZAZ-ja, **cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë** e votimit dhe të materialeve zgjedhore para numërimit dhe pas numërimit, si dhe një hapësirë për kutitë e votimit të vlerësuara "KUTI E PARREGULLT".
- Sapo kutitë e votimit janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e caktuar. Ky proces mbikëqyret nga KZAZ-ja.
- KZAZ duhet t'i vendosë **kutitë në grupe sipas numrit njësisë së qeverisjes vendore** në rend zbritës.
- Kutia me fletët e votimit vendoset në pozicion vertikal, njëra mbi tjetrën në mënyrë që sipër kutisë me materialet e votimit të jetë kutia me fletët e votimit.



## Marrja e kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve të votimit

Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve të votimit, grupi marrjes në dorëzim :

- Merr nga KZAZ-ja, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV dhe që përmban: Model **PV-KZAZ-06** dhe modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së.



PV-KZAZ-06

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

- **shënojnë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim Model PV-KZAZ-09 numrat e kodeve të sigurisë së vulave,** me të cilat është mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit/zgjedhore;

- **verifikojnë në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë të vulave,** me të cilat janë mbyllur kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit me numrat e kodeve të sigurisë, sipas Procesverbalit për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, Model **PV-KZAZ-06**, të mbajtur për këtë qendër votimi.

Kur grupet e marrjes në dorëzim konstatojnë se:

- **kodet e sigurisë nuk përputhen;**
- **mungojnë ose janë këputur** një ose më **shumë vula me kode sigurie**;
- vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë që lejon **hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;**
- kutia ka në trupin ose në kapakun e saj **thyerje ose çarje** që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose
- kutia është e llojit, **formës ose përmasave të ndryshme** nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja;

**informon menjëherë KZAZ-në për parregullsinë** dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "KUTI E PARREGULLT". **KZAZ**-ja **verifikon menjëherë** parregullsinë dhe **merr vendim** dhe e regjistron atë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim **PV-KZAZ-09** dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

**Në asnjë rrethanë grupet e numërimit nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit apo me materiale të tjera logjistike që vijnë në VNV nga KQV-ja.**

**Kujdes:** Me marrjen në dorëzim nga të gjitha KQV-të të kutive të fletëve të votimit dhe të kutive me materialet zgjedhore, sekretari i KZAZ-së porosit operatorin të njoftojë në rrugë elektronike në KQZ rregullsinë e tyre. Për këtë operatori hedh në formën përkatëse në kompjuter të dhënat që i jep sekretari i KZAZ-së, kutitë e parregullta, nëse ka.

Ju mund t'i referoheni n.115, p.7 e KZ, n.5, p.1 e U.nr.17 dhe n.6 i U. nr.18

## Nëse nuk ka parregullsi

Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari dhe sekretari i KQV-së, si dhe punonjësi i policisë i caktuar për shoqërim nënshkruajnë **Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim PV-KZAZ-09**. Origjinali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim **PV-KZAZ-09** administrohet nga KZAZ-ja, e cila u jep nga **një kopje** përkatësisht kryetarit, sekretarit të KQV-së dhe punonjësit të policisë të caktuar për shoqërimin. Punonjësi i policisë duhet të largohet menjëherë pas marrjes së kopjes së procesverbalit, e cila dorëzohet së bashku me raportin e shërbimit në komandën e tij/saj. Një kopje e **PV-KZAZ-09** dorëzohet nga KZAZ-ja në KQZ .

Procesverbali i Marrjes në Dorëzim duhet të përmbajë kohën e marrjes në dorëzim, numrin e qendrës së votimit, vulat me kodet e sigurisë, me të cilat është mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, hapësirën për përshkrimin e mospërputhjeve ose parregullsive të konstatuara, si dhe hapësirën për nënshkrimet.


PV-KZAZ-09
REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

| | | | |
|---|---|---|---|
| KZAZ: | | Qarku: | |
| KQV Nr: | | Datë: | |

1. Kuti Votimi me nr. të vulave të sigurisë: (kutia e votimit duhet të jetë e vulosur me 5 vula (kode))
1.1 Kjo kuti votimi është: a. e rregullt ☐ b. e parregullt ☐
1.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:
KUTIA E VOTIMIT ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:
1) 2) 3) 4) 5)

2. Kuti e Materialeve Zgjedhore me nr. të vulave (kodeve) të sigurisë: (duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode)
2.1 kutia e materialeve zgjedhore është: a. e rregullt ☐ b. e parregullt ☐
2.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:
KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:
1) 2) 3) 4)

3. VULA REZERVË TË PAPËRDORURA:
1) 2) 3)

4. Koha e marrjes në dorëzim : Datë / /2013 Ora : :

| Punonjësi i Policisë se Shtetit: | Dorëzuesi nga: KQV nr. ______ | Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim: |
|---|---|---|
| | Kryetar: | Anëtar: |
| | Sekretar: | Anëtar: |

VULA e KZAZ-së

**Model PV-KZAZ-09**

Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit/zgjedhore, të marra në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, vendosen në vendin e përcaktuar.




## 2. Kutitë e parregullta *(n. 115 i KZ)*

Kutitë e parregullta dërgohen në këndin **e kutive të parregullta.**

Në rast se gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutisë me fletët e votimit apo kutisë me materialet e votimit, konstatohet një apo më shumë parregullsi, grupi i marrjes në dorëzim, njofton menjëherë KZAZ-në për parregullësinë dhe i kërkon asaj, që kutia përkatëse të shënohet "KUTI E PARREGULLT". sh."b", p.2, n.115

Anëtarët e KZAZ-së përkohësisht ndërpresin punën e tyre në këto grupe, paraqiten tek vendi i dorëzimit të kutisë përkatëse të votimit, kutisë së materialeve të votimit, e verifikojnë parregullsinë e konstatuar dhe marrin vendim, duke e vlerësuar kutinë si të parregullt, i vendosin etiketën "KUTI E PARREGULLT".







**Kujdes**:Të gjitha mospërputhjet apo parregullësitë e konstatuara gjatë këtij procesi, shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së dhe në Procesverbalin e Konstatimit p.4, n.115 e *KZ*

Në rastin kur **kutia** me fletët e votimit e një KQV-je është vlerësuar si e parregullt, atëherë ajo vendoset **në këndin e kutive të parregullta**. Kutia me materialet e votimit i nënshtrohet verifikimit gjatë procesit të numërimit, nese do te jetë e nevojshme.

Kutia me fletët e votimit e përcaktuar si "**KUTI E PARREGULLT**" në asnjë rast dhe për asnjë arsye **nuk hapet** nga KZAZ-ja dhe as nuk i kalojnë Grupit të Numërimit. Ato **dërgohet së bashku me kutinë e materialeve të votimit/zgjedhore në KQZ** për nevoja të hetimit administrativ.

**KZAZ-ja mban Procesverbal Konstatimi,** në të cilin shënohen të dhënat për kutinë me fletët e votimit ose kutinë me materialet e votimit/zgjedhore të deklaruara **të parregullta**. Kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare, nëse e kërkojnë.

**b.** Në rastin kur kutia me fletët e votimit është marrë në dorëzim e rregullt dhe kutia e materialeve të votimit përcaktohet "KUTI E PARREGULLT", kutia me fletët e votimit i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe numërimit.

Në rastin **kur** Kutia me fletët e votimit është e rregullt, ndërsa **kutia me materialet e votimit** vlerësohet si "**KUTI E PARREGULLT,** Kutia me fletet e votimit numërohet.

**c.** Kutia e materialeve të votimit hapet gjatë procesit të numërimit të votave **vetëm** në rastet kur mungon Procesverbali i Mbylljes së Votimit Model PV-KQV-08, ose të dhënat nuk janë plotësuar në pëputhje me n.113. sipas procedurave të parashikuara p.1, n.116/1 të KZ.

# III. PROCESI I NUMËRIMIT

## 1. Veprimet paraprake të KZAZ *(N. 9, U. 18)*

**Pasi janë marrë në dorëzim të gjitha materialet zgjedhore** nga të gjitha qendrat e votimit, **KZAZ-ja** merr masat për fillimin e procesit të numërimit të votave si më poshtë:

- Sigurohet që **Vendi i** Numërimit të Votave është **gati** për fillimin e procesit të numërimit të votave.
- Sigurohet që **anëtarët e Grupeve të Numërimit janë prezent në VNV** dhe janë të ulur në tavolinat përkatëse të numërimit.
- Sigurohet që Grupet e Numërimit janë të pajisur **me materialet e nevojshme logjistike** për procesin e numërimit të votave.
- Verifikon që të pranishëm në VNV, janë vetëm **personat e autorizuar**.
- Merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal **të teknologjisë mbështetëse** të numërimit të votave.





## 2. Fillimi i procesit të numërimit (p.10, n.115, n.116 i KZ)

Vendim **KZAZ-ja** merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave, **vetëm pasi ka marrë në dorëzim** edhe bazën materiale të QV-së së fundit nën juridiksionin e saj. Ky vendim, në të cilin shënohet dhe **ora e saktë e fillimit të procesit** të numërimit të votave regjistrohet **në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.** *(n. 11 i U. 18)*

**REFUZIMI I NUMËRIMIT TË VOTAVE ÇON NË SHKARKIMIN E MENJËHERSHËM TË PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR NUMËRIMIN OSE TË ANËTARËVE TË KZAZ-SË DHE PËRBËN NJËKOHËSISHT KUNDRAVAJTJE PENALE!**

Radha Anëtarët e grupeve të numërimit, **me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, marrin nga stiva e kutive të votimit** kutitë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe i vendosin pranë tryezës së Grupit të Numërimit përkatës.

Në vijim, anëtarët e **Grupit të Numërimit** marrin nga sekretari i KZAZ-së **modelin e depozituar krahasues të vulës** së kryetarit të KQV-së.



## 3. Hapja e Kutive të Votimit *(n.116 i KZ)*

GNV kryen **veprimet e mëposhtme**:

- **Numëruesi i parë** vendos mbi tryezë **kutinë e votimit me fletët e votimit** dhe e hap atë, duke këputur vulat me kodet e sigurisë.
- Anëtaret e GNV-së, nxjerrin nga kutia **Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, model PV-KQV-08**
- **dhe** verifikojnë nëse ai është plotësuar saktë.


PV-KQV-07

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Model **PV-KQV-07**


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL

Model **PV-KQV-08**

**Kur Procesverbali i Mbylljes së Votimit PV-KQV-08 mungon apo nuk është plotësuar , Grupi i Numërimit plotëson Procesverbalin e Konstatimit,** Model **04 R dhe FILLIMISHT kontrollon kutinë e materialeve të votimit.**

Nëse Procesverbali i Mbylljes së Votimit është plotësuar **në mënyrë të saktë**, Numëruesi i Parë dhe anëtarët e Grupit të Numërimit:

- nxjerrin nga kutia **fletët e votimit**,
- **shpalosin** fletët e votimit dhe

- i vendosin ato **mbi tryezë me anën e pasme të fletës nga ana e sipërme**.





Fletët e votimit të stivuara sa më sipër **numërohen nga Numëruesi i Parë,** i cili ia bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Shifra e deklaruar **verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve** të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit **PV-KQV-08**. Nëse shifrat **nuk përputhen** ose nëse **kërkohet** nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar **të rifillojë** edhe një herë numërimin e fletëve të votimit.

Nëse sërish konstatohen **mospërputhje**, atëherë:

- GNV-ja ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton **menjëherë KZAZ-në**. Njoftimi bëhet **me ngritjen e dorës** dhe pa lëvizur nga vendi.

- Ngritja e dorës **pezullon** çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri sa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

Në rast **se KZAZ-ja konfirmon parregullsinë, e pasqyron në Proceverbalin e Konstatimit.** Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave, nga GNV-ja. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja nëse do të vazhdojë procesi i numërimit i bëhet i ditur menjëherë Grupit të Numërimit.

## 4. Hapja e kutive të materialeve të votimit (p.1, n.116 i KZ)

**Kutia e materialeve të votimit hapet vetëm në rastet kur Procesverbali i Mbylljes së votimit mungon në kutinë me fletët e votimit ose kur të dhënat nuk janë plotësuar saktë në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit.**

Grupi i Numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që konstaton parregullsinë me Procesverbalin e Mbylljes së Votimit**, njofton menjëherë KZAZ-në**, duke ngritur dorën dhe pa lëvizur nga vendi.
Ngritja e dorës **pezullon** çdo veprim të mëtejshëm të Grupit të Numërimit, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në **Procesverbalin e Konstatimit**.
Më pas, KZAZ-ja mund të marrë **vendim** për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit/zgjedhore.
Kutia me fletët e votimit vendoset pranë tavolinës së numërimit dhe **numëruesi i parë merr kutinë e materialeve të votimit** të qendrës së votimit përkatëse.

**Kontrolloni nëse Procesverbali i Mbylljes së Votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit!**

Grupi i Numërimit hap kutinë e materialeve të votimit, duke këputur vulat me kodet e sigurisë. Në fillim verifikohet nëse **në kuti ndodhet Procesverbali për Mbylljen e Votimit**, i plotësuar në mënyrë të rregullt. Nëse **GJENDET**

- plotësohet **Procesverbali i Konstatimit** dhe
- Procesverbali **për Mbylljen e Votimit** i jepet KZAZsë.

Më pas **kutia me materialet e votimit/zgjedhore mbyllet** me kode sigurie dhe Grupi i Numërimit **vazhdon me numërimin e votave**.

Kur Procesverbali për Mbylljen e Votimit **NUK GJENDET** në kutinë e materialeve të votimit**/zgjedhore** apo **NUK ËSHTË PLOTËSUAR** në mënyrën e duhur, Grupi i Numërimit plotëson **PROCESVERBALIN E KONSTATIMIT** dhe më pas ndjek këto procedura:

- GNV **verifikon nëse në kuti ndodhen**:



  - zarfi "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA";
  - zarfi "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA";
  - lista e zgjedhësve, përfshirë edhe regjistrin e posaçëm;





  - vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së;



  - vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
  - vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka;



  - Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së; dhe



  - dokumentacioni shoqërues i fletëve të votimit me seritë përkatëse.

KZAZ të marrë një vendim ku të cilësohet çfarë mungon;

- Fletët e votimit të papërdorura;
- Fletët e votimit të dëmtuara;

Në këtë rast kutia me fletët e votimit nuk mund të numërohet dhe çështja i kalon KQZ-së.

**Numëruesi i parë**

- **krahason vulën** e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ua bën të ditur anëtarëve të grupit;
- **numëron fletët e votimit të papërdorura** dhe shifrën ua bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjëri prej anëtarëve të grupit, kryhet edhe një herë numërimi i fletëve të votimit të papërdorura.
- **numëron fletët e votimit të dëmtuara** dhe ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjëri prej anëtarëve të grupit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit të dëmtuara.
- **numëron zgjedhësit që kanë votuar**, sipas nënshkrimeve të tyre në listën e votuesve, përfshirë edhe ata në regjistrin e posaçëm dhe ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e zgjedhësve që kanë votuar. Vërejtjet shënohen në Procesverbalin e Konstatimit.
- **hedh të dhënat në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit**, Model **57-13**, për numrin të fletëve të votimit të dorëzuara në KQV, sipas dokumentacionit shoqërues të tyre.

**Më pas kutia mbyllet me kode sigurie dhe Grupi i numërimit vazhdon me numërimin e votave sipas procedurave të përshkruara më lart.**

*Pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve* (Model **57-13)***,Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në përkatëse, sipas modelit* Model **40-13**;
***Tabela Përmbledhëse e Rezultateve, e printuar***, ***kontrollohet nga anëtarët e KZAZ-së*** *dhe* ***miratohet me vendim*** për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, Model **40-13 V**. *Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.*

**Në përfundim të numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të ZAZ-së, kutitë e materialeve të votimit/zgjedhore dërgohen në KQZ së bashku me kutitë e votimit.**

## 5. Vlerësimi i fletëve të vlefshme dhe të pavlefshme *(n.117 KZ)*

Si hap i parë, fletët e votimit ndahen në **vota të VLEFSHME**, në **vota të PAVLEFSHME dhe në vota të Kontestuara.** Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore apo partinë politike pjesëtare të koalicionit në fletën përkatëse të votimit. (shih shembujt e mëposhtëm)
**Numëruesi i parë i Grupit të Numërimit hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi**, bën vlerësimin e saj me zë të lartë, duke vepruar sipas kësaj radhe:
1. Ai/ajo verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën **madhësi, ngjyrë ose formë** me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; në rast të kundërt, ai/ajo e vlerëson këtë fletë votimi si të pavlefshme;

2. Ai /ajo verifikon nëse në fletën e votimit është **vula e KQV-së** dhe **vula e kryetarit të KQV-së**; në rast të kundërt, ai/ajo e vlerëson votën të pavlefshme;

3. Ai/ajo verifikon nëse ekziston ndonjë nga shkaqet e tjera për deklarimin e votës sit ë pavlefshme, në mënyrë të posaçme nëse:

- në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që **bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;**
- në fletën e votimit janë bërë **shënime** në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
- është **votuar për më shumë se një** nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- nuk është **votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore** në fletën e votimit;
- nuk është **e qartë se për kë** është votuar; ose
- zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk **është në fletën e votimit**.

**Shembuj të fletëve të votimit të vlefshme** (v.172, dt.27.02.2013):


FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për Kuvendin, 23.06.2013

MODEL 1-A

QARKU ________ ZAZ Nr.______

QV Nr. ______

SUBJEKTET ZGJEDHORE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ALXXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | ALX | 1 | |
| 2 | BMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | BML | 2 | |
| 3 | XXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLQ | EMRI MBIEMRI | XCV | 3 | |
| 4 | PARTIA XCVBMLPNJKLFDREPU | EMRI MBIEMRI | PXVBF | 4 | |
| 5 | PARTIA ABMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | PABFDS | 5 | |
| 6 | PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDS | EMRI MBIEMRI | PBPN | 6 | |
| 7 | PARTIA BBMLPNJKLFDREPUTSERKL | EMRI MBIEMRI | KLQRP | 7 | |
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 1-B

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 1-C

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 1-D

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 1-E

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 1-F

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |


FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për Kuvendin, 23.06.2013

MODEL 2-A

QARKU ________ ZAZ Nr.______

QV Nr. ______

SUBJEKTET ZGJEDHORE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ALXXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | ALX | 1 | |
| 2 | BMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | BML | 2 | |
| 3 | XXXCVBMLPNJKLFDREPUTSERKLQ | EMRI MBIEMRI | XCV | 3 | |
| 4 | PARTIA XCVBMLPNJKLFDREPU | EMRI MBIEMRI | PXVBF | 4 | |
| 5 | PARTIA ABMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | PABFDS | 5 | |
| 6 | PARTIA BMLPNJKLFDREPUTSERKLQPERTFDS | EMRI MBIEMRI | PBPN | 6 | |
| 7 | PARTIA BBMLPNJKLFDREPUTSERKL | EMRI MBIEMRI | KLQRP | 7 | |
| 8 | PARTIA BLFDREPUTSERKLQPERTFDSA | EMRI MBIEMRI | UTS | 8 | |
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |

MODEL 2-B

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |
| 10 | PARTIA DFDREPUTSERKLQPERTFD | EMRI MBIEMRI | PFGS | 10 | |

MODEL 2-C

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |
| 10 | PARTIA DFDREPUTSERKLQPERTFD | EMRI MBIEMRI | PFGS | 10 | |

MODEL 2-D

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |
| 10 | PARTIA DFDREPUTSERKLQPERTFD | EMRI MBIEMRI | PFGS | 10 | |

MODEL 2-E

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | PARTIA DBMLPNJKLFDREPUTSE | EMRI MBIEMRI | NJKL | 9 | |
| 10 | PARTIA DFDREPUTSERKLQPERTFD | EMRI MBIEMRI | PFGS | 10 | |

**Vlerësimi i vlefshmërisë së votave ka si synim të identifikojë, sa më shumë që të jetë e mundur, vullnetin e votuesit.**

## 6. Vlerësimi i fletës së votimit (n.118 i KZ)

GNV-ja duhet të përgatisë **hapësirë të mjaftueshme në tavolinë** për t'i vendosur fletët e votimit në stivë, të ndara në **fletë votimi për secilin subjekt zgjedhor, vota të pavlefshme dhe vota të kontestuara**.

Gjatë numërimit fletët e votimit ndahen në grupime të votave për çdo subjekt. Në rast se nuk ka vend në tavolinë, atëhere GN mund të përdorë mbajtëse me ndarje, me gjerësinë e fletës së votimit, me të cilën e ka pajisur KQZ, duke identifikuar në mënyrë të qartë numrat e subjekteve zgjedhore.

Në rastin e koalicioneve, votat e vlefshme për secilën parti anëtare të koalicionit grupohen veçmas dhe pranë njëra-tjetrës, duke bërë të mundur identifikimin e votave për partitë anëtare të koalicionit.

**Numëruesi i parë:**

- **merr** një fletë votimi dhe jep vlerësimin e tij/të saj;
- **ia tregon** fletën e votimit anëtarëve të tjerë të GNV-së dhe ua propozon për vlerësim se cilës parti politike apo kandidati i është hedhur vota;
- **e vendos** fletën e votimit në **kamerën regjistruese,** jo më pak se **4 sekonda**, në mënyrë që të shikohet qartësisht në monitor shenja, e cila tregon vullnetin e zgjedhësit.

Në rast se anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore janë dakort me vlerësimin e numëruesit të parë, **fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit** dhe vendoset në vendin e caktuar **për subjektin politik** për të cilën është votuar. Numëruesi i parë vazhdon me fletën tjetër të votimit.

Në rast se ndonjëri nga **anëtarët e Grupit të Numërimit ose çdo vëzhgues** i subjekteve zgjedhore, **nuk është dakort** me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar **për fletët e votimit të kontestuara** dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

Kontestimi i votës bëhet duke ngritur dorën e duke thënë "NUK JAM DAKORT".

Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit, Grupi i Numërimit **rivlerëson fletët e votimit të kontestuara.** Në rast se mbeten ende fletë votimi të kontestuara, atëherë Numëruesi i parë ose çdo anëtar thërret **KZAZ-në** për **vlerësimin e votave të kontestuara.** KZAZ–ja bën në çast vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje me të. Rezultati i shpallur nga KZAZ–ja shënohet **në Librin e Protokollit të KZAZ–së** dhe përfshihet **në tabelën** përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit.



PV-GNV-10

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL
I Grupit të Numërimit të Votave për mbyllien e kutisë së materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013

| KZAZ | KQV nr. | GNV nr. |
|---|---|---|
| | | |

Grupi i Numërimit, pasi bëri verifikimet për materialet zgjedhore të gjetura në kutinë e materialeve zgjedhore të Qendrës së Votimit nr. ________, e mbylli kutinë me materialet zgjedhore me vulat (kodet) e sigurisë të mëposhtme:

| 1) | 2) | 3) | 4) | 4 VULA |
|---|---|---|---|---|

Për Grupin e Numërimit:

Numuruesi i Parë — Sekretari:

1. Anëtar i Grupit të Numërimit: ________ (emër, mbiemër, firmë)
2. Anëtar i Grupit të Numërimit: ________ (emër, mbiemër, firmë)

Datë: ___/___/ 2013



PV-GNV-10-1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL
I grupit të numërimit të votave për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara, për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të dates 23 Qershor 2013
Baza ligjore: neni 118 pika 5, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

| KZAZ | KQV nr. | GNV nr. |
|---|---|---|
| | | |

Në përfundim të numurimit të fletëve të votimit, GN rivlerësoi fletët e votimit të kontestuara dhe pasi KZAZ bëri vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara, GN regjistroi numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara :

| Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara : | |
|---|---|

Për Grupin e Numërimit:

Numëruesi i parë (emër, mbiemër, firmë) — Sekretari (emër, mbiemër, firmë)

1. Anëtar i Grupit të Numërimit: ________ (emër, mbiemër, firmë)
2. Anëtar i Grupit të Numërimit: ________ (emër, mbiemër, firmë)

Datë: ___/___/ 2013

**Model PV-GNV-10** **Model PV-GNV-10-1**

**Për seicilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit.**

Për votat e kontestuara mbahet një procesverbal i veçantë, Model **PV-GNV-10-1**, në të cilin pasqyrohet numri i përgjithshëm i votave të kontestuara për KQV-në përkatëse.
Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, fletët e votimit të cilësuara si të kontestuara dhe procesverbali përkatës, futen në **zarfin e "FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA**".

## 7. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore *(n. 118 i KZ)*

### Numëruesi i Parë

- numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar **sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit**.
- **ia bën të ditur** shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve .

Në rast se, kërkohet nga ndonjë anëtar i Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e votave për atë subjekt.

Në rast se, edhe pas këtij numërimi të dytë ka përsëri **kundërshtime**, numëruesi i parë ose anëtari kundërshtues, njofton KZAZ–në **nëpërmjet ngritjes së dorës**. Ngritja e dorës **pezullon çdo veprim të mëtejshëm** të GNV-së, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ–ja. **KZAZ–ja numëron në vend votat** për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron Grupin e Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi.

**Numëruesi i parë dhe sekretari i Grupit të Numërimit përgjigjen për zbatimin e detyrimeve që lindin nga kontestimi i fletës së votimit. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet me gjobë.**

# 8. Nxjerrja e rezultatit (n.119)

Përpara plotësimit të Tabelës së Rezultateve të Votimit, model 57-13, nga anëtarët e GN-it, KZAZ i jep sekretarit të GNV-së:
**PV-GNV-10** (për mbylljen/vulosjen e kutisë së materialeve zgjedhore);
**PV-GNV-10-1** (për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara).
**Numëruesi i Parë,** së bashku me anëtarët e tjerë të GNV-së plotëson **tabelën e rezultateve** për atë qendër votimi, Model **57-13**.

**KUJTOHUNI të shënoni në tabelën e rezultateve numrat e kodeve të cilat do të përdoren për vulosjen e kutisë së votimit me votat e numëruara!**

**Tabela origjinale** e rezultateve, përfshirë edhe kontestimet **i dorëzohet menjëherë** dorazi KZAZ-së nga GNV-ja. **Kopje** e tabelës së rezultateve i jepet çdo anëtari të **Grupit të Numërimt dhe vëzhguesve** të subjekteve zgjedhore, nëse e kërkojnë (fotokopje në letër A3).

**Një kopje e Tabelës së Rezultateve** dërgohet **menjëherë** në mënyrë elektronike **në KQZ.**

Nëse ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka **kundërshtime** në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen menjëherë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së. p.2, n.119.

Pas nxjerrjes së tabelës së rezultateve **fletët e votimit futen në zarfe të ndara**, për SUBJEKTET ZGJEDHORE;
- "VOTA TË VLEFSHME"- zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt, **model Z.06**;
- "VOTA TË PAVLEFSHME"- zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme, **model Z.05**;
- "FLETË VOTIMI TË KONTESTUARA"- zarfi i fletëve të votimit të kontestuara, **model Z.04**;

Të gjitha këto zarfe, si dhe zarfi me Procesverbalin e Vulosjes **futen në kutinë e votimit.**
**Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes, PV-GNV-10,** së bashku me **Procesverbalin për Mbylljen e Votimit, PV-KQV-08** i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së. Një kopje e Procesverbalit të Vulosjes i jepet dhe **vëzhguesve** të subjekteve zgjedhore.
Kutia me fletët e votimit të numëruara **vendoset në vendin e caktuar,** vazhdohet me një kuti tjetër nga një tjetër qendër votimi dhe vazhdon procesi i numërimit.

**Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara si të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit mund të ndërpritet vetëm me vendim të KZAZ-së. Shkaqet argumentohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, përfshirë edhe vendimin për rifillimin e numërimit.**

Sekretari i KZAZ-së shënon në LPM të KZAZ-së:
- Numrin e GN-it;
- Tabelën Origjinale të Rezultateve të QV-së, përkatëse, **model 57-13**, të shoqëruara me kopjet e saj.
- Kodet e sigurisë, të cilat shërbejnë për mbylljen e kutisë me fletët e votimit për subjektet zgjedhore, të shënuara në Tabelën Origjinale të Rezultateve të QV-së, **model 57-13.**

**Në asnjë rast dhe për asnjë arsye fletët e votimit nuk shfaqen më shumë se një herë në kamera.**





## 9.TRANSMETIMI ELEKTRONIK DHE NXJERRJA E TABELËS PËMBLEDHËSE TË REZULTATEVE NGA KZAZ-JA

### 9.i.Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së,

Tabela origjinale e rezultateve për Qendrën e Votimit, për **model 57-13**, i dorëzohet nga numëruesi i parë menjëherë KZAZ-së. KZAZ përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin që përmban tabela **model 57-13**:

- numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
- numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
- numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
- numrin e fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit;
- numrin e votave të pavlefshme;
- numrin e votave të vlefshme;
- shpërndarjen e votave të vlefshme, për subjektet.

Kjo realizohet menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GNV-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV-ve sipas kësaj mënyre:

**a.** Sekretari i KZAZ-së, pasi GNV-ja i dorëzon tabelën e rezultateve të një QV-je, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave. Operatori i hedh të dhënat e tabelës së rezultateve në aplikimin elektronik në kompjuter dhe printon në letër informacionin që ka në formë elektronike. Në momentin e printimit aplikimi elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.

**b.** Tabela e printuar nga forma elektronike i dorëzohet GNV-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave.

**b.1.** Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, sekretari i KZAZ-së i jep të drejtë operatorit dhe e udhëzon atë të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet drejt KQZ-së.

**b.2.** Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GNV-së bën korrigjimet me shkrim dore në fletën e printuar dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GNV-së. Sekretari i KZAZ kthen aplikimin elekronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe dërgimit në KQZ.

Formati i printuar dhe tabela origjinale e rezultateve i bashkëngjiten njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar, që i dorëzohet KQZ-së.


QARKU__________

GN NR _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KZAZ NR ___
TABELË E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Numri i zgjedhësve që kanë votuar | | |
| 2 | Fletë votimi të papërdorura | | |
| 3 | Fletë votimi të dëmtuara | | |
| 4 | Fletë votimi të gjetura në kuti | | |
| 5 | Vota të pavlefshme | | |
| 6 | Vota të vlefshme | | |

Grupi i Numërimit Nr.___

| Nr. | | | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | | Numërues i parë | |
| 2 | | Sekretar | |
| 3 | | Anëtar | |
| 4 | | Anëtar | |

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, 23.06.2013

Pas transmetimit të të dhënave të çdo QV-je në KQZ, tabela **model 57-13**, kopje të tabelave të rezultateve (fotokopjohen në makinën printer/fotokopje, që ndodhet në VNV), të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

### 9.ii.Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve nga KZAZ-ja

- Tabelë përmbledhëse e rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor, **Model 40-13**;
- Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zonën e administrimit zgjedhor, **Model 40-13 V**.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve të ZAZ-së, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve të njësisë, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në, **model 40-13**. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve e ZAZ-në, e printuar, kontrollohet nga anëtarët e KZAZ-së dhe miratohet me vendim **model 40-13 V**. Pas kësaj sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, konfirmimin e miratimit. Kjo procedurë vazhdon deri në nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultateve për njësinë e fundit të ZAZ-së, e cila duhet të ketë përfunduar **jo më vonë se ora 22.00** e (n.122, p.1) ditës së nesërme të votimit.

Në rast se për arsye të ndryshme nuk mund të printohet Tabela Përmbledhëse e Rezultateve nga baza elektronike e të dhënave, atëhere sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, **model 40-13.** Këto tabela përmbledhëse janë të paraprintuara me subjektet sipas përmbajtjes së fletës së votimit. Në këto tabela pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti, për çdo qendër votimi, sipas origjinaleve të tabelave të rezultateve të QV-ve, të njësisë përkatëse plotësuar nga GN-të.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, kopje të tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit, u jepen anëtarëve të KZAZ-së

dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinalet e tyre, vulat dhe çdo material tjetër zgjedhor dorëzohen në KQZ.

**Kujdes**: Procedurat për transmetimin elektronik të të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së dhe nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së, janë të njëjta ...”.




## Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje

Veprimet e KZAZ-së gjatë ditës së zgjedhjeve për marrjen nga KQV-të dhe dhënien në KQZ të informacionit **për pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim** janë si më poshtë:

- Sekretari i KZAZ-së, nëpërmjet ndihmësit të tij teknik, çdo tre orë, pas orës 7-00 të hapjes së votimit, kërkon dhe merr nga sekretari i KQV-së përkatëse numrin e zgjedhësve, që kanë votuar deri në atë moment. Në mbylljen e votimit KZAZ i kërkon KQV-së veç numrit të përgjithshëm të zgjedhësve, që kanë votuar në atë QV edhe sa nga këta votues janë femra.
- Menjëherë pas marrjes së informacionit nga KQV-ja, ndihmësi teknik shënon në kompjuterin e KZAZ-së shifrën e marrë nga sekretari i KQV-ve në vendet përkatëse të tabelës së parapërgatitur (Lidhja 1, Vendimi 42).
- Jo më vonë se 30 minuta nga koha për marrjen e informacionit nga qendrat e votimit (pra, jo më vonë se ora 10-30, 13-30, 16-30 dhe 19-30), KZAZ njofton në KQZ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar deri në atë moment, duke dhënë, në se ka, dhe QV-të që për ndonjë arsye nuk kanë dhënë informacion.
- Në njoftimin e fundit (pas mbylljes së votimit), pra jo më vonë se ora 19-30, KZAZ njofton në KQZ dhe numrin e përgjithshëm të femrave, që kanë votuar.

Transmetimi i informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje gjatë ditës së votimit jepet me mesazh zanor me anë të telefonit celular dhe kur është e mundur edhe në rrugë elektronike. Për këtë, partitë politike që propozojnë për emërimin e sekretarit të KQV-së, krahas të dhënave të tjera, japin në KZAZ dhe numrin e telefonit celular të tyre.

**Kujdes:** Ju mund t'i referoheni v. nr.42, dt.02.12.2010

# IV. VËZHGUESIT





## 1. Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve *(N. 7 KZ)*

Të gjithë vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve kanë këto të **drejta**:

- të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
- të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
- të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;

Vëzhguesit kanë **këto detyra:**

- të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
- të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;
- të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, procedurat e ditës së zgjedhjeve, procesin e numërimit të votave, shpalljen e rezultateve dhe aktivitetin e komisioneve zgjedhore;
- të ndjekin rregullat e etikës brenda mjediseve zgjedhore;
- të mos komentojnë dhe/ose të debatojnë vendimet e KZAZ-së dhe GNV-së (n.11, U.13)

## 2. Vëzhguesit në VNV

Partitë politike dhe koalicionet mund të kërkojnë për çdo VNV, akreditimin e një numri vëzhguesish të barabartë me **numrin e tavolinave të numërimit**, që do të kenë në këto ambiente zgjedhore. Vëzhguesi i KZAZ-së mund të jetë vëzhgues dhe në VNV (p. 6, n.3 U. 10).

KQZ i dërgon KZAZ-së një listë me emrat e kandidatëve të ZZ përkatëse dhe personi që kontrollon hyrjen në VNV, **çekon në listë, emrin e kandidatit të paraqitur me dokumentin e identifikimit.**

**Në VNV nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues nga një subjekt për tavolinë numërimi.**

**Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes** . Përkthyesi është i pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja *(N. 9, p. 5,6 e U. 13).*

**Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore** të akredituar në VNV kanë **këto të drejta**:

- të njoftojë KZAZ-në (njoftimi bëhet me ngritjen e dorës) në rast të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave dhe gjatë verifikimit të materialeve zgjedhore;
- të kundërshtojë vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë;
- Të marrin kopje të Tabelës përmbledhëse të rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të procesverbaleve të konstatimit.

Vëzhguesit kanë **këto detyra:**

- të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së, ku janë akredituar
- të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KZAZ-ja, të shoqëruar me dokument identifikimi (pasaportë, kartë identiteti);
- të mos pengojnë procesin numërimit të votave;

**Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akredituar në VNV gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga Grupet e Numërimit janë të detyruar të qendrojnë në vendin e caktur për ta nga KZAZ-ja.**

Vëzhguesit duhet të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me komisionerët zgjedhorë dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit.

# V. PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET




## 1. Veprat penale

Anëtarët e **komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike** në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë **përgjegjësi penale dhe administrative**, sipas legjislacionit:

**Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve te zgjedhjeve** (n. 326)

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një deri në

pesëvjet.
Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

**Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor** (n. 326/a)

Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.
Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet.

**Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje**(n. 329)

…Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.
Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet".

**Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve** (n. 330/a)
Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.
Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet".

**Rastet e përgjegjësisë penale dhe administrative të anëtarëve dhe sekretarit**

- ✓ Kur shkelja nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë; p.1
- ✓ Shkeljet e tjera të dispozitave të KZ, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1 000 deri në 2 500 lekë; n.171, p.2
- ✓ Kur sekretari shkel rregullat e përcaktuara në n. 34 të KZ dhe aktet nënligjore dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj; n.171, p.3
- ✓ Kur shkelin rregullat e tjera të parashikuara në Pjesën II të KZ dhe kur nuk përbën shpërdorim të detyrës sipas nenit 248 të Kodit Penal, dënohen me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë; n.171, p.5

**Kujdes!** **Numëruesi i parë** dhe **sekretari i GN-i**t janë **përgjegjës për zbatimin e detyrimeve** që lindin nga kontestimi i fletëve të votimit. **Mospërmbushja** e këtyre detyrimeve, sipas n.171 të KZ, **ndëshkohet me gjobë**. (p.7, n.118)

## **Sanksionet për shkelje të parimeve të Kodit Zgjedhor** (n.172 i KZ)

- ✓ Kur shkelin ndonjë nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4 ose 5 të Kodit

Zgjedhor, në rastet kur kjo shkelje nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, kryejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. n.172, p.1

- ✓ Kur shkelin ndonjë nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenet 3, 4 ose 5 të KZ, dhe kjo shkelje ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, kryejnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet; n.172, p.4

## Modelet e dokumentacionit të punës në VNV:

Procesverbali i marrjes në dorëzim të kodeve të sigurisë PV-KZAZ-06;

Procesverbali i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV: PV-KZAZ-09;

Procesverbali PV-KQV-05;

Procesverbali i vulosjes PV-KQV-07;

Procesverbali i mbylljes së votimit PV-KQV-08;

Procesverbali i mbylljes së Kutive të Votimit nga GN: PV-GNV-10;

Procesverbali i fletëve të votimit të kontestuara: PV-GNV-10-1;

Tabelë e rezultateve për QV-të Model **57-13**, të cilën e nxjerr GNV;

Tabelë Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së, të cilën e nxjerr KZAZ, Model **40-13**;

Vendim për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, Model **40-13 V**;

Vendim për caktimin e grupeve të numërimit të votave, Model 05 V;

Vendim për emërimin e anëtarëve të grupit të numërimit, Model 06 V;

Vendim, Model **XX V**

## Modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së:

**-Model 01 R**: Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së. KZAZ-ja pasqyron në LPM:

- mbledhjet dhe veprimtarinë e përditshme të KZAZ-së;
- informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë, të cilat sipas rastit, i verifikon ato.

**- Model 02 R**: Regjistri i vendimeve të KZAZ-së. Sekretari i KZAZ-së regjistron vendimet e KZAZ-së,...nga emërimi i anëtarëve të GNV-ve, procesit të marrjes në dorëzim të mateialeve zgjedhore deri në përfundim të procesit zgjedhor, sipas numrit rendor.

**- Model 03 R**: Regjistri i korrespondencës së KZAZ-së.Sekretari i KZAZ-së protokollon të gjitha kërkesat, ankesat dhe njoftimet që i drejtohen KZAZ-së, si dhe çdo dokument tjetër që i adresohet në funksion të punës së saj të përditshme.

**- Model 04 R**: Procesverbal Konstatimi. Sekretari i KZAZ-së mban procesverbal konstatimi, ku shënohen të gjitha parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive të votimit nga KQV-ja në KZAZ dhe gjatë procesit të numërimit të votave në VNV.

**Vendime:**

**V. nr**. 11, dt.10.01.2013 "Për miratimin e modeleve të shenjave dalluese që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013".

**V. nr**.20, dt.28.01.2013 "Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve, për zgjedhjet për për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23.06.2013".

**V.nr.266**, dt.23.04.2013 Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit që do të përdoret nga KQV-ja, në Zgjedhjet për Kuvend të datës 23 Qershor 2013.

**V. nr.172**, dt.27.02.2013 "Për unifikimin e praktikës së vlerësimit të fletëve të votimit nga personat e ngarkuar nga Kodi Zgjedhor, për numërimin dhe vlerësimin e votave".

**V. nr.**176, dt.9.03.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.7, dt.23.03.2009".

**V. nr.**179, dt 25.03.2013 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 10, datë 14.04.2009 ”Për procedurat për kriteret e akreditimit të vëshguesve të subjekteve zgjedhore nëKZAZ,KQV,VNV, nga KZAZ- ja për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28.06.2009”.

**V. nr.42**, dt.02.12.2010 "Për miratimin e procedurave për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit për pjesëmarrjen në zgjedhje ditën e votimit”.

**Udhëzime:**

**U. nr.1**, dt.15.01.2013 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 1, datë 20.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore”.

**U. nr**.**1**, dt. 20.02.2009 "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Zyrave Rajonale Zgjedhore”.

**U. nr.3**, dt.19.02.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së”.

**U.nr**.**7**, dt.23.03.2009 "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhjet për Kuvendin 2009”.

**U. 10**, dt.14.04.2009 "Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV dhe VNV, nga KZAZ-ja, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28 qershor 2009".

**U. nr**.**12**, dt.21.04. 2009- "Për caktimin dhe përgatitjen e Vendit të Numërimit të Votave, mënyrën e ngritjes së Grupeve të Numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”.

**U. nr**.**13**, dt.22.04.2009- Udhëzimi "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave”.

**U. nr**.**18**, dt. 03.06.2009- Udhëzimi "Për mënyrën e organizimit të punës në VNV, rregullat që duhen ndjekur nga KZAZ-ja dhe GNV-të, radhën e veprimit dhe ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit të votave i ndryshuar”.

**KODI I SJELLJES PËR KOMISIONERËT ZGJEDHORË**

Për t'iu përmbajtur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri dhe profesionalizëm, komisionerët zgjedhorë duhet:

- Të punojnë për t'i ofruar çdo votuesi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar për t'u mundësuar votuesve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.
- Të kryejnë detyrën në mënyrë të pavarur, transparente dhe të paanshme.
- Të punojnë konform ligjeve shqiptare, të zbatojnë Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së dhe t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre, për të siguruar zgjedhje të standarteve ndërkombëtare të lira, të drejta dhe transparente.
- Të marrin vendime të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.
- Të zhvillojnë mbledhje të hapura për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, përfshirë edhe aksesin e lirë në informacionin, mbi bazën e të cilit merren vendimet.
- Të kryejnë të gjitha detyrat e tyre në mënyrë rigorozisht jo-partiake dhe politikisht neutrale.
- Të mos shprehin pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje.
- Të mos mbajnë apo tregojnë simbole apo ngjyra partiake të dukshme.
- Te trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (kandidatët, partitë politike dhe votuesit) në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi.
- Të veprojnë në mënyrë profesionale.
- Të jenë të trajnuar dhe disiplinuar, si dhe të angazhuar të trajtojnë materialet zgjedhore me kujdes dhe respekt.
- Të respektojnë standardet më të larta të etikës në lidhje me komisionerët e tjerë zgjedhorë, kandidatët, vëzhguesit dhe votuesit.
- Të sillen në mënyrë të pagabueshme, të ushtrojnë gjykim të shëndoshë dhe të kenë standardet më të larta të maturisë personale.
- Të mënjanojnë diskutime ose intervista të cilat mund të interpretohen si mbështetje e politikave ose ankimimeve të ndonjë partie politike ose kandidati politik.
- Të trajtojnë përfaqësuesit e mediave me mirësjellje dhe respekt.
- Të mos pranojnë ndonjë dhuratë apo favor nga partitë politike, organizatat apo personat, të cilët mund ose jo të jenë të përfshirë në procesin zgjedhor.
- Të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar që do ketë barazi të mundësive për votuesit, partitë politike dhe kandidatët.
- Të mos marrin pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesi me detyrat e tyre si administrues zgjedhorë.
- Të deklarojnë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.

**<u>Përgatiti :</u>**

**Etleva NUMANI : Përgjegjëse e S. Trajnimit**

**Alfred SPAHIU : Drejtor i DKZTEZ**